

Akt Themelimi

I shoqërise tregtare **“Kodra Konstruksion” SH.P.K.**

Mbeshtetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512 datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lire dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit”, të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare”, me vullnetin e tyre të lire, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, në ortakun znj. **Albana Kodra**, me nr. personal identifikimi **H162170930**, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“Kodra Konstruksion” SH.P.K.** me akt themelimi si vijon:

Formulimi

Neni 1

Sot, me datë 22/03/2018, formohet shoqëria tregtare private e quajtur **“Kodra Konstruksion” SH.P.K.** Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa deget që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

Selia e Shoqërisë

Neni 2

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: “Tiranë Luz i vogël LUZ I VOGEL Luz i Vogel, Rruga nacionale Kavaje - Rrogozhinë km-5, zona kadastrale nr.8552, pasuria nr.12/338, objekt 1-katesh, magazine”.

Objekti i Veprimtarisë

Neni 3


Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Aktivitet në fushën e ndërtimit, shfrytëzimin, përpunimin, tregtimin dhe transportin e inerteve, si dhe të materialeve të tjera të ndërtimit.

Tregti material ndërtimi, ndertime të ndryshme, civile, fasada termoizoluese. Rikonstruksione banesash dhe vepra arti, apartamente, shtëpi banimi, rrugë, ura, dhe të tjera në fushën e ndertimeve civile dhe industriale.

Import - eksport prodhim, tregtim detergjentesh profesional, shtëpiake industriale, tregtim artikuj të ndryshëm ushqimorë.

Prodhim, tregtim, magazinim, import, eksport i bojërave të të gjitha llojeve, përfshirë edhe ato që lidhen me hidroizolim, import, eksport të materialeve të ndryshme që lidhen dhe janë në funksion të aktivitetit të sipërcituar, prodhim e tregtim i artikujve të ndryshëm të veshjeve të të gjitha llojeve duke krijuar marrëdhënie bashkëpunimi, ekonomike e profesionale me shoqëri të tjera të ngjashme, të të njëjtit lloj, shitje, ndertime e punime në metale ose në materiale sintetike për llogari të vet ose të të tretëve, marrja përsipër e përfaqësimit edhe ekskluzivisht i shoqërive vendase dhe të huaja, prodhuese ose tregtuese të prodhimeve të sipërpërmendura, transport për llogari të vet dhe të tretëve, agjensi për shitje dhe blerje pasurish të paluajtshme dhe të luajtshme, agjensi për shitje biletash udhëtimi të llojeve të ndryshme, të udhëtimeve në rrugë detare, ajrore etj, ndërtim, gërmime dheu dhe punime të llojeve të ndryshme që lidhen me ndërtimin, pa kufizim, etj.



Kohezgjatja e Shoqerise
Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar. Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku.

Kapitali i Shoqerise
Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqind mijë) Lekë.

1. Ortaku themelues: Albana Kodra, zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë) lekë, që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Drejtimi i Shoqerise
Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj **z.Kadri Kodra**, me nr.personal identifikimi **G60530103A** , i cili do te jete dhe perfaqesuesi ligjor i saj. Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posaçme.

Neni 7
Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut.

Neni 8

Ortaku ka te drejte te emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale.

Ka te drejte te caktojte financiere, likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtojte persona te tjere si ortakë.

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Kavaje.

Neni 10
Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11
Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .

Neni 12
Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "Kodra Konstruksion" SH.P.K.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortakut.

Ortaku themelues

Albana Kodra

